



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:066483

Datë: 11.07.2019

Numri i dokumentit: 00405162

P.nr.790/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja Diana Sina, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit L.H. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë me numër PP.nr.1342/2018, të datës 05.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën **11.07.2019**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Dëshire Jusaj, të akuzuarit, të dëmtuarit L.L. të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **L.H.**, i biri i K. dhe i ëmës Z. e gjinisë R., data e lindjes..., në Gjakovë, ku edhe tani banon, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, i pa martuar, numër personal

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse: Me datë 26.08.2018 në rrugën “S.S.” në Gjakovë, tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit në atë mënyrë natën kritike rreth orës 22.00 gjatë një loje me dorëza të boksit gjersa po lozte, i dëmtuari L.L.me shokun e tij L.H. dhe personi L.H e kishte goditur disa herë pa u ndalur edhe pse i dëmtuari disa herë i ka kërkuar që të ndalonte së goditurit atëherë në shenjë nervoze është tensionuar mes të dyve ashtu që i pandehuri – vëllau i L.H ka reaguuar dhe e ka goditur me thikë në dorë dhe këmbë duke i shkaktuar kështu të dëmtuarit lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko-ligjore e Dr.M.G.e dt.24.09.2018.

- me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 17 par.1, 41, 49, 50, 51, 52,73, dhe nenit 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton;

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale në emër të ekspertizës mjeko ligjore të paguaj shumën prej **20,00 Euro**, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-Euro**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30.00 Euro** e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari L.L. nga Gjakova, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1342/2018, të datës 05.11.2018, kundër të akzuarit L.H. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 të KPRK-së, Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj pasi lexoi aktakuzën bënë përmisimin e kualifikimit juridik të veprës penale ashtu që pas paragrafit 2 duhet të jetë lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, ndërsa pjesa tjetër e dispozitivit të aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari L.H. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë dhe premtoi para gjykatës se një vepër të tillë nuk do ta përsëris, shton se menjëherë pas rastit këtu të dëmtuarit L.L.i kam kërkuar falje për veprimet e mia si dhe në bazë të traditave tona jemi takuar dy familjet dhe i njëjti ma ka falur gabimin, të dëmtuarin L. e kam pasur shok të ngushtë edhe tani e kam shok të mirë dhe vazhdimisht rijmë se bashku, dhe prej atij momenti raportet tona shoqërore janë të mira, shton se jam i pa punë, me gjendje të dobët materiale, për herë të parë paraqitem në Gjykatë për një vepër të kryer penale, por premtoi se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoi gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ti merr parasysh rrethanat e lartë cekura dhe të më shqiptoi një dënim më të butë.

I dëmtuari L.L. deklaroi, se unë si palë e dëmtuar nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkoj kompensimin e dëmit, menjëherë pas rastit L. më ka kërkuar falje për veprimet e bëra të cilin e kam pasur dhe tani e kam shok të mirë, jemi në të njëjtën lagje dhe vazhdimisht rijmë së bashku dhe prej atij momenti i njëjti nuk ka përsëritur veprën penale, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh këto rrethana dhe të njëjtit ti shqiptoi një dënim sa më të butë.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akzuarit, prokuroria i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari L.H.: Me datë 26.08.2018 në rrugën "S.S." në Gjakovë, tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit në atë mënyrë natën kritike rreth orës 22.00 gjatë një loje me dorëza të boksit gjersa po lozte, i

dëmtuari L.L.me shokun e tij L.H. dhe personi L.H e kishte goditur disa herë pa u ndalur edhe pse i dëmtuari disa herë i ka kërkuar që të ndalonte së goditurit atëherë në shenjë nervoze është tensionuar mes të dyve ashtu që i pandehuri – vëllau i L.H ka reaguar dhe e ka goditur me thikë në dorë dhe këmbë duke i shkaktuar kështu të dëmtuarit lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko-ligjore e Dr.M.G.e dt.24.09.2018.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjyquese konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është i pa punë, gjendjen e tij të dobët ekonomike, pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë veprë penale, sjelljet e tij tejet korrekte në gjykim, pajtueshmërinë e tij me të dëmtuarin, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata ka marr parasysh peshën e veprës penale të kryer, motivet për kryerjen e veprës, rrethanat në të cilat është kryer vepra, intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me veprimet e tija i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit, andaj duke marr parasysh këto rrethana, Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nën par.2.1 dhe 2.6 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -

P.nr.790/18 me datën 11.07.2019

**Procesmbajtësja,
Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Diana Sina**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.